



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

## NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.376/2023

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-** Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të pandehurit, Z... P... nga fshati P... Komuna e P..., të cilin sipas detyrës zyrtare e përfaqëson avokat F... K... nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.756/2023, të datës 26.05.2023 pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 03.07.2023, publikisht shpalli, këtë:

### A K T G J Y K I M

**Ndaj të pandehurit: Z... P...** nga babai M... dhe nëna M... e lindur A..., i lindur më datë ... në Gj..., me vendbanim në fshatin P..., K.P..., i martuar, babë i shtatë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të varfër ekonomike, me numër personal 1..., s..., shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R S E P S E

Më datë 08.05.2023 rreth orës 12.00h, në fshatin P..., K.P..., në shtëpinë familjare, i pandehuri Z... P..., me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor ka ushtruar dhunë në familje duke e lënduar lehtë të dëmtuarën-bashkëshorten e tij B... P..., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje verbale, pasi nuk kishte gjetur bukë të blinte i drejtohet të dëmtuarës pse ajo nuk kishte përgatitur vetë por vetëm këndonte, dhe kur ajo i thotë se nuk ndjehej mirë, i pandehuri fillon të bërtasë duke e sharë me fjalë të ulëta me çrast e njëjta gjuan me një tigan por nuk e godet, ndërsa i pandehuri i revoltuar përnjëherë e godet me grusht në pjesën e pasme të kokës – tek veshi i majtë që për shkak të intensitetit të goditjes e dëmtuara rrëzohet në tokë dhe ka vështirësi në frymëmarrje përkundër ndihmës së fëmijëve për disa çaste nuk mund të ngritet deri sa vie në vete, e që si pasojë të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore në formë të kontuzioneve në laprën e veshit të majtë dhe në kokë të pasojë edhe me dhimbje të veshit të evidentuara në raportin mjekësor nr.82 të dt.08.05.2023. të lëshuar nga Spitali Regjional në Gjilan-Emërgjenca,që sipas ekspertizës mjekoligjore konsiderohen si dëmtime të lehta me pasoja të përkohshme për shëndetin.

**-Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par.3.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,44,48,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-ës, të pandehurin e,

## G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 ditësh, i cili dënim do të zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 800(tetëqind euro) të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë me dy(2) këste mujrore nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera të parapara me nenin 43 par 3 të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobë do ti zëvendësohet në dënim burgu, ashtu që për çdo 20 euro do ti llogaritet një ditë burgu.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 08.05.2023 deri me datë 07.06.2023 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20€ (njëzet euro), shumën prej 20€ (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të kimit, si dhe 30 euro për ekspertizën mjekoligjore të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.756/2023 të datës 26.05.2023, kundër të pandehurit Zoran Periq nga fshati Pisjan Komuna e Pasjanit, për shkak të veprës penale lëndim lëndim i lehtë trupor nga mneni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 03.07.2023, i pandehuri në të cilin ishin prezent Prokurorja e Shtetit, i pandehuri, me mbrojtësin e tij në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i njëjti deklaroi se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale. Me këtë pranim të fajësisë së tij janë pajtuar prokurorja e shtetit dhe i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

### 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores së shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, konform nenit 242 të KPPK-së,ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### **3. Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri Z... P... nga fshati P... Komuna e P..., për shkak të veprës penale lëndim lëndim i lehtë trupor nga mneni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-së.

### **4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit të shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 120 ditësh, i cili dënim do të zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqindë) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë me dy (2) këste mujrore nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale ashtu që për të akuzuarin e lartcekur, si rrethanë lehtësuese e ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë, se i njëjti është penduar, i njëjti i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej më veprë penale, po ashtu e dëmtuara ka heq dorë nga ndjekja penale dhe kompensimi i dëmit po ashtu është baba i 7 fëmijëve. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh dashjen e tij për kryerjen e veprës penale të lartcekur.

### **6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me gjobë mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### **Vendimi për llogaritjen e paraburgimit**

Koha e kaluar në paraburgim nga data 08.05.2023 deri me datë 07.06.2023 konform nenit 79 të KPP-së do të llogaritet në dënimin e shqiptuar

### **7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale**

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor në shumë prej 20€ (njëzet euro), dënimin prej 20€ (njëzet euro) për mbrojtjen e viktimave të krimit, si dhe konform nenit 449 paragrafi 2.1 të KPP-së, të paguaj ekspertizën mjeko ligjore në shumë prej 30 euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.376/2023, me datë 26.07.2023

**Bashkëpunëtore Profesionale  
Vlora Selmani -Rahimi**

**Gjyqtari,  
Veli Kryeziu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas vlerësimit të mbrojtjes të pandehurit në fjalë dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës mori dhe në prani të Prokurorit të shtetit, dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**Ndaj të pandehurit: Zoran Periç** nga babai Milan dhe nëna Milka e lindur Arsiç, i lindur më datë 10.03.1963 në Gjilan, me vendbanim në fshatin Pisjan, K.Partesh, i martuar, babë i shtatë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje te varfër ekonomike, me numër personal 1234850802,sërb, shtetas i Republikës së Kosovës.

## **Ë S H T Ë F A J T O R S E P S E**

Më datë 08.05.2023 rreth orës 12.00h, në fshatin Pisjan, K.Partesh, në shtëpinë familjare, i pandehuri Zoran Periç, me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor ka ushtruar dhunë në familje duke e lënduar lehtë të dëmtuarën-bashkëshorten e tij Biljana Periç, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje verbale, pasi nuk kishte gjetur bukë të blinte i drejtohet të dëmtuarës pse ajo nuk kishte përgatitur vetë por vetëm këndonte, dhe kur ajo i thotë se nuk ndjehej mirë, i pandehuri fillon ti bërtasë duke e sharë me fjalë të ulëta me çrast e njëjta gjuan me një tigan por nuk e godet, ndërsa i pandehuri i revoltuar përnjëherë e godet me grusht në pjesën e pasme të kokës – tek veshi i majtë që për shkak të intensitetit të goditjes e dëmtuara rrëzohet në tokë dhe ka vështirësi në frymëmarrje përkundër ndihmës së fëmijëve për disa çaste nuk mund të ngritet deri sa vie në vete, e që si pasojë të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore në formë të kontuzioneve në laprën e veshit të majtë dhe në kokë të pasojë edhe me dhimbje të veshit të evidentuara në raporti mjekësor nr.82 të dt.08.05.2023. të lëshuar nga Spitali Regjional në Gjilan-Emërgjenca,që sipas ekspertizës mjekoligjore konsiderohen si dëmtime të lehta me pasoja të përkohshme për shëndetin.

**-Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par.3.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,44,48,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-ës, të pandehurin e,

## **G J Y K O N**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 ditësh, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit do të zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 800(tetëqind euro) të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë me dy(2) këste mujrore nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20€ (njëzet euro), shumën prej 20€ (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, si dhe 30 euro për ekspertizën mjekoligjore të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Përfundoi në ora 11.40

Vë r t e t o j n ë

Zyrtarja Ligjore,

G j y k a t ë s i